

DOKUMENT BASHKËPUNIMI

MBI

IDENTIFIKIMIN E PRIORITETEVE TË PËRBASHKËTA PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

HYRJE

Ky dokument prezanton hapat e bashkëpunimit në përmbushje të prioriteteve të përbashkëta me shoqërinë civile për periudhën 2014-2017, që synojnë nxitjen e reformave të sistemit penitenciar, plotësimin e standardeve për trajtimin me dinjitet të personave në konflikt me ligjin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore për kategoritë e personave.

Prioritetet bazohen në politikat ekzistuese të Qeverisë Shqiptare të orientuara drejt perspektivës Evropiane.

Ky dokument synon planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta mbështetur në prioritetet të zbatueshme dhe të prekshme.

Forcimi i sundimit të ligjit dhe respektimi i parimeve demokratike e të drejtave themelore, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë prioritetet më të rëndësishme të adresuara nga Bashkimi Evropian, duke theksuar rëndësinë e tyre në zhvillimin e demokracisë shqiptare. Bashkëpunimi me shoqërinë civile ka për qëllim zbatimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut, si dhe krijimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislativës të BE-së mbi të drejtat themelore.

Prioritetet e përbashkëta mbështeten në çështjet e identifikuar nga sistemi i burgjeve, si dhe ato të ngritura përgjatë procesit konsultativ me dokumente, opinione dhe raporte për sistemin e burgjeve.

KUSHTET AKTUALE

Kuadri ligjor i funksionimit të sistemit të burgjeve

Legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë penale dhe sistemit të burgjeve dhe parandalimit të krimit njih disa akte, që përbëjnë bazën e legjislacionit *Acquis Communautaire*:

- a) **Karta:** Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.
- b) **Traktate:** Traktati i Lisbonës, Traktati i Mahstrihtit për BE-në dhe Traktati i Funkcionimit të BE-së.
- c) **Direktiva:**
 - Direktiva 2012/29 e 25 tetorit 2012 vendosjen e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;
 - Direktiva për vendosjen e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;
 - Direktiva mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale;
 - Direktiva mbi të drejtën e informimit në procedurë penale;
 - Direktiva e Këshillit në lidhje me kompensimin e viktimave të krimit.
- d) **Rregullore:**
 - Rregullorja për njohjen e ndërsjellë të masave mbrojtëse në çështjet civile.
- e) **Vendime:**
 - Vendimi për krijimin e Eurojust
 - Vendimi Kuadër për urdhër Dëshmitë Evropian
 - Vendimi Kuadër i Këshillit për zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale (2008)
 - Vendimi Kuadër i Këshillit mbi vendimet e shërbimit të provës dhe dënimeve alternative
 - Vendimi Kuadër për zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të urdhrave të konfiskimit
 - Vendimi Kuadër i Këshillit për zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të ndëshkimeve financiare
 - Vendimi Kuadër mbi ekzekutimin në Bashkimin Evropian të urdhrave ngrirjes pronë ose dëshmi
 - Vendimi Kuadër i Këshillit mbi pozitën e viktimave në procedurën penale
- f) **Konventa**
 - Europol: Zyra e Policisë Evropiane
 - Konventa mbi Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale
 - Marrëveshja Shengen në mes BE-së dhe Qeverisë Shqiptare
 - Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore
 - Konventa Evropiane për ndihmë të ndërsjellë në çështjet penale
 - Akti i Këshillit për themelimin e Konventës për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale mes vendeve të BE-së
 - Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut (ECHR)

g) Rekomandime

- Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec. (2006) 2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të zëvendës ministrave).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec. (2008) 11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rregullat evropiane për të miturit nënshtrohen sanksioneve ose masave (të miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 2008 at nëntor 1040 takimi i zëvendës ministrave).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec. (2012) 5 i Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi Kodin Evropian të Etikës për stafin e burgjeve (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 prill 2012at takimi 1140 të zëvendës ministrave)
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec. (98) 71 i Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg (të miratuara nga komiteti i ministrave më 8 prill 1998 në takimin e 627 të zëvendës ministrave)
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec. (2004) 10 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të personave me çrregullime mendore.

Legjislacioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara:

a) Konventat:

- Deklarata Universale për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
- Konventa kundër torturës, trajtimit çnjerezor e degradues dhe Protokolli Opsional
- Konventa për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijës
- Konventa për Eliminimin e Diskriminimit racor

b) Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve

- Rregullat për mbrojtjen e të gjithë personave që ndodhen nën cdo formë arresti
- Rregullat për mbrojtjen e të miturve që iu privohet liria
- Rregullat për trajtimin e grave të Burgosura dhe masat alternative për gratë në burgim("Rregullat e Bangkokut")

Kushtetuta e RSH i rendit në mënyrë të hollësishme të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kushtetuta e ka veçuar Konventën Evropiane nga tërësia e normave ndërkombëtare. Neni 17 i Kushtetutës vendos barazinë juridike të Konventës me Kushtetutën për sa i takon kufizimit të drejtave dhe lirive themelore. Kushtetuta ka njohur epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare ndaj ligjeve të vendit. Në Kushtetutë, në kreun mbi liritë dhe të drejtat vetjake janë parashikuar, midis të drejtave të tjera, edhe të drejtat e personit në procesin penal, si:

1. E drejta e personit që i hiqet liria, të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet;

2. E drejta të komunikojë menjëherë me avokatin e tij;
3. E drejta e trajtimit njerëzor dhe e respektimit të dinjitetit të personit etj.

Ligji Nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim" i ndryshuar, ka përcaktuar qëllimin e tij sipas të cilit, për të paraburgosurit dhe të dënuarit duhet të realizohet një trajtim që synon rehabilitimin për integrimin e tyre në jetën shoqërore. Ligji përcakton programimin dhe realizimin e trajtimit, individualizimin e trajtimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar, llojet e institucioneve për ekzekutimin e dënimeve penale, trajtimin mjekësor etj.

Ligji nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar sanksionon procedurat për punësimin, përcaktimin e detyrave, përgjegjësisë, sistemin e gradave, në dhënien e masave disiplinore punonjësve të policisë së burgjeve.

Në bazë të ligjit të sipërpërmendur është miratuar Nr. 303, datë 25.3.2009 ndryshuar me V.K.M.-në nr. 187 date 17.03.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 303 datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

Kuadri institucional

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bazë të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili ndjek dhe drejton organizimin dhe funksionimin e sistemit të burgjeve dhe të paraburgimit, ekzekutimit të vendimeve penale, në funksion të trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve. Misioni i DPB është të garantojë sigurinë, trajtimin human dhe kushtet e nevojshme për rehabilitimin social dhe ri-integrimin në shoqëri të shtetasve të paraburgosur dhe të dënuar. Prioritet për DPB-në është përmirësimi i kushteve standarde dhe trajtimit të personave të privuar nga liria në përputhje me politikën e qeverisë shqiptare, si dhe përafrimin e tyre me standardet e BE. DPB-ja organizon, menaxhon dhe kontrollon të gjitha institucioneve penitenciare (22) në varësi të saj. Burgjet dhe paraburgimet përbëjnë autoritetet administrative të cilat zbatojnë vendimet e Gjykatës për mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e personave të dënuar dhe të paraburgosur, duke garantuar trajtimin njerëzor dhe me dinjitet. Aktualisht janë 19 burgjeve dhe qendrave të paraburgimit në vendin tonë, 1 Institucion Special të Shëndetësisë për të burgosurit e dënuar dhe të paraburgosur në Tiranë, 1 Institucion për të Miturit në Kavajë dhe 1 Institucion Special në Krujë për trajtimin e të burgosurve me sëmundje kronike dhe të moshuarit. Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, kanë për detyrë pranimin, garantimin e sigurisë, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve. DPB ka të punësuar 3766 punonjës.

Kushtet aktuale në sistemin e burgjeve

Respektimi dhe mbrojtja e të Drejtave Themelore të Njeriut, duhet të jetë në përputhje me kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), veçanërisht kërkesat që rrjedhin nga Pjesa 1 mbi Parimet e Përgjithshme, duke iu referuar nenit 2 dhe nga Titulli VI mbi Përafrimin e Ligjeve dhe Zbatimin e Ligjit, me referencë të posaçme në nenin 70: *“Duke marrë parasysh angazhimin e Palëve për rritjen e lirive politike e ekonomike që janë bazat themelore të kësaj marrëveshjeje, si dhe angazhimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe parimet demokratike nëpërmjet një sistemi shumë partiak me zgjedhje të lira e të ndershme....Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje....Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij efektiv. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me legjislacionin e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm do të zbatohet siç duhet.”*

Opinionit i Komisionit Evropian mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim (2013)^[1] vuri theksin në mënyrë të veçantë në sektorin e të drejtave themelore. Raporti i Progresit thekson se: *"Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa konkretë për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për të zbatuar në mënyrë efektive politikat kundër diskriminimit – të dy këto fusha janë ndër përparësitë kryesore. Masat janë marrë për forcimin e parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit, një tjetër fushë e mbuluar nga një prioritet kyç i Opinionit (Komisioni Evropian 2013 : 41). "Në disa fusha të drejtave themelore, kuadri ligjor është përmirësuar dhe janë marrë disa hapa inkurajuese praktike Shumë nga rekomandimet e Avokatit të Popullit mbi keqtrajtimet janë adresuar nga burgjet; prioritet kyçe lidhur me trajtimin e të burgosurve janë përmbushur (Komisioni Evropian 2013: 46).*

Raporti i Progresit 2014 nënvizoi, se përveç zhvillimeve dhe reformave të bëra në sistemin e burgjeve, çështje të rëndësishme mbeten të pa adresuara. Këto çështje janë:

- Përmirësimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës së institucioneve penitenciare;
- Hetimi në rastet e shkeljes së ligjit;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për shpërblimin për punën e të burgosurve;
- Ulja e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit.

^[1]Dokument i stafit të punës të Komisionit, Raporti i Progresit për Shqipërinë, 2013, që shoqëron Dokumentin e Komunikimit nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Strategjia e Zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014 {com (2013) 700final}, Bruksel, 2013/10/16, SWD (2013) 414 final.

- Përmirësimi i shërbimit shëndetësor dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor;
- Përmirësimi i përgatitjes profesionale të punonjësve të institucioneve të vuajtjes së dënimit;
- Forcimi i masave kundër korrupsionit në sistemin penitenciar.

Ekzistojnë institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, kryesisht paraburgime, që funksionojnë mbi kapacitetet dhe mbeten për t'u përmirësuar kushtet e përgjithshme të tyre. Aksesit në shërbimet shëndetësore sidomos ai psikiatrik, si dhe kushtet higjieno-sanitare nuk ofrohet gjithmonë sipas standardeve. Ndonëse zhvillohen trajnime të stafit policor dhe civil të sistemit penitenciar, ka nevojë për konsolidim të kurrikulës dhe instrumentave të vlerësimit të trajnimeve. Krijimi i aksesit të plotë për monitorim nga Avokati i Popullit dhe organizatatave të shoqërisë civile, ka qenë një ndër arritjet e sistemit penitenciar, ndërkohë mbetet për t'u përmirësuar procesi i analizës dhe planifikimit të saktë të rekomandimeve të dhëna. Gjithashtu, duhet forcuar bashkëpunimi mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal, shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit për të bërë të mundur krijimin e rrjeteve mbështetëse pas lirimit të të dënuarve, për të bërë të mundur riintegrimin e tyre në shoqëri.

Hartimi i rregullave dhe procedurave të qarta antikorrupsion mbetet një tjetër çështje tjetër e ndjeshme për sistemin penitenciar.

Prej disa vitesh tregues të rëndësishëm matës të zhvillimit të reformës në sistemin penitenciar, mbeten raportet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues ose Ndëshkimit (KPT). Gjatë vizitës së fundit në Shqipëri (4-14 Prill 2014), Delegacioni i KPT parashtroi si prioritet nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të reformës në sistemin e burgjeve, për përmirësimin e respektimit të drejtave të personave me liri të kufizuar.

PRIORITETET E PËRBASHKËTA

Prioritetet e përbashkëta të bashkëpunimit me OJF

Prioritetet e përbashkëta të bashkëpunimit janë vendosur nga një process i vazhdueshëm konsultativ, mbështetur në ecurinë e deritanishme të reformës së sistemit të burgjeve.

Prioritetet konsistojnë në zbatimin e objektivave të listuara si më poshtë:

1. Përafrimi i legjislacionit të sistemit të burgjeve në përputhje me legjislacionin e BE.

1.1 Përmirësimi i akteve nënligjore

1.1.1 Amendime në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve (2014);

- 1.1.2 Miratimi i Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (2014);
- 1.1.3 Miratimi i VKM-së për nxitjen dhe shpërblimin për punën e të paraburgosurve dhe të dënuarve (2014);
- 1.1.4 Miratimi i rregullores së personelit të burgjeve (2014);
- 1.1.5 Miratimi i Rregullores së brendshme të policisë së burgjeve (2014);
- 1.1.6 Miratimi i Rregullores së re të disiplinës dhe kodin e etikës për policinë e burgjeve (2014);
- 1.1.7 Miratimi i Rregulloreve të reja për IEVP (2015);
- 1.1.8 Miratimi i një rregulloreje të veçantë për trajtimin e të miturve të paraburgosur dhe të dënuar (2015);
- 1.1.9 Miratimi i Rregullave Standarde për kategorizimin dhe specifikimin e trajtimit për personat me nevoja të veçanta (2015).

2. Përmirësimi i kushteve për kategorinë e personave me liri të kufizuar, mbështetur në trajtimin human dhe jo-diskriminues.

2.1 Ulja e mbipopullimit në sistemin e burgjeve dhe paraburgimeve.

- 2.1.1 Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me sktorë dhe grupet e interesit mbi çështjet e mbipopullimit (2015);
- 2.1.2 Hartimi i sistemi elektronik të analizës dhe standardeve për uljen e mbipopullimit, dhe problematikave të ndërruarura (kushteve materiale, trajtimit njëzëror, rehabilitimit, etj.) (2015-2016).

2.2 Përmirësimi i kujdesit dhe shërbimit shëndetësor për personat me liri të kufizuar.

- 2.2.1 Përmirësimi dhe ruajtja e një standardi të qëndrueshëm të kushteve higjieno-sanitare në IEVP (2014);
- 2.2.2 Përmirësimi i sigurimit të medikamenteve (2014-2015);
- 2.2.3 Hapja e Sektorëve të Kujdesit të Veçantë për personat me çrregullime të shëndetit mendor në sistemin penitenciar (2014-2015);
- 2.2.4 Përmirësimi i trajtimit të specializuar për riaftësimin shëndetësor (2015);
- 2.2.5 Kalimi i shërbimit shëndetësor të sistemit të burgjeve në varësi të MSH (2017);

2.3 Përmirësimi i procesit të rehabilitimit social dhe ri-integrimit në shoqëri të personave me liri të kufizuar:

- 2.3.1 Orientimi i sistemit të burgjeve drejt praktikave më të mira evropiane për ofrimin e shërbimeve cilësore të arsimit, formimit profesional dhe punësimit (2014-2017);

- 2.3.2 Hartimi i programeve të ri-integrimit, me fokus kategoritë në nevojë si të miturit, gratë, 18-21 vjeçar dhe personat pa mbështetje (2014);
- 2.3.3 Hartimi i protokolleve standarde mbi përgatitjen për ri-integrim për kategoritë specifike (2014);
- 2.3.4 Bashkëpunim me institucione shtetërore, OJF dhe komunitetin e biznesit, për ndërtimin e rrjeteve mbështetëse pas lirimit (2015);
- 2.3.5 Aplikimi për projekte të përbashkëta me shoqërinë civile me fokus rehabilitimin dhe përgatitjen për ri-integrim (2014-2017);
- 2.3.6 Bashkëpunimi me Strukturat e Sherbimit të Proves dhe pushtetin vendor për të adresuar nevojat e grupeve me nevoja të veçanta dhe përfitimin e alternativave perkundrejt burgimit (2015).

2.4 Krijimi i një sistemi efektiv për nxitjen e punësimit dhe shpërblimin për punën e të paraburgosurve dhe të dënuarve.

- 2.4.1 Bashkërendimi i veprimtarisë së punës me institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera me qëllim punësimin dhe shpërblimin e drejtë e të paraburgosurve dhe të dënuarve (2015);
- 2.4.2 Nxitja e iniciativave private për punësimin e të burgosurve brenda dhe jashtë sistemit (2015);
- 2.4.3 Krijimi i mundësive për zbatimin e projekteve në bashkëpunim me komunitetin e biznesit për ofrimin e laboratoreve apo punishteve të prodhimit brenda sistemit penitenciar (2015-2017);
- 2.4.4 Nxitja e punës kërkimore për gjetjen e zgjidhjeve dhe zbatimin e metodave bashkëkohore për punësimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve (2015-2017).

2.5 Rritja e performancës profesionale dhe operacionale të punonjësve të sistemit penitenciar

- 2.5.1 Hartimi i protokolleve për qartësimin e kompetencave dhe detyrave funksionale të personelit (2014);
- 2.5.2 Konsolidimi i kurrikulës së trajnimeve dhe vlerësimit (2015);
- 2.5.3 Forcimi i kapaciteteve trajnuese, nëpërmjet zhvillimit të programeve “Trajnim trajnerësh” (2014);
- 2.5.4 Organizimi i trajnimeve për punonjës të niveleve të ndryshme për ngritje në karrierë, si dhe aftësitë menaxheriale të drejtimit (2015);
- 2.5.5 Konsolidimi i një sistemi trajnimesh specifike për stafet që punojnë me të miturit, gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuar dhe çrregullime të shëndetit mendor, si dhe në çështjet e mos-diskriminimit dhe parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit (2014-2017);

3. Përmirësimi i infrastrukturës fizike, materiale dhe teknologjisë në sistemin penitenciar.

3.1 Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve aktuale.

- 3.1.1 Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe materiale në institucionet/sectorët për të miturit (2014);
- 3.1.2 Përmirësimi i kushteve materiale për të paraburgosurit dhe të dënuarit (2014-2016);

4. Forcimi i partneritetit për respektimin e të drejtave të njeriut në sistemin penitenciar.

4.1 Rritja e bashkëpunimit me institucione shtetërore

- 4.1.1 Rinovimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me MMSR për procesin e formimit profesional në IEVP (2014);
- 4.1.2 Bashkëpunimi me institucione dhe agjenci shtetërore në nivel lokal (2014-2015);

4.2 Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile

- 4.2.2 Bashkëpunimi për identifikimin e prioriteteve në funksion të zbatimit të projekteve të përbashkëta
- 4.2.3 Kryerja e studimeve kërkimore-shkencore me interes të përbashkët

5. Eliminimi i akteve korruptive dhe fenomeneve të tjera negative në sistemin e burgjeve.

5.1 Përmirësimi i procedurave antikorrupsion

- 5.1.1 Ngritja e një grupi pune për hartimin e udhëzuesve administrativë kundër korrupsionit (2014);
- 5.1.2 Krijimi i një database për standardizimin dhe administrimin e rastet korruptive në sistemin e burgjeve (2014);
- 5.1.3 Forcimi i adresimit për ndjekje ligjore të rasteve të korrupsionit në administratën e burgjeve (2014-2017);
- 5.1.4 Organizimi i fushatave sensibilizuese me personat me liri të kufizuar për denoncimin e rasteve korruptive dhe abuzive në IEVP (2014-2017);
- 5.1.5 Konsolidimi i bashkëpunimit për identifikimin e akteve korruptive (2014-2017).

PLANI i PËRBASHKËT i VEPRIMIT

Nr.	Objektivat specifikë	Veprimet që duhen ndërmarrë	Koha e realizimit	Institucionet përgjegjëse	Organizatrat partnerë	Kontributi që do të ofrohet
1. Objektivi strategjik: Përfaqja e legjislacionit të sistemit të burgjeve në përputhje me legjislacionin e BE.						
1.1	Përmirësimi i akteve nënligjore	1.1.1 Amendime në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve	2014	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children, QSHPLI, "Përthyerje", MERIDIA, FZKPM.	Rekomandime specifike prezantuar DPB dhe M.Drejtësisë
		1.1.2 Miratimi i Rregullore së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	2014	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children, QSHPLI, "Përthyerje", MERIDIA, FZKPM.	Rekomandime specifike prezantuar DPB
		1.1.3 Miratimi i VKM-së për nxitjen dhe shpërblimin për punën e të paraburgosurve dhe të dënuarve	2014	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children, QSHPLI, "Përthyerje", MERIDIA, FZKPM.	Rekomandime specifike prezantuar DPB
		1.1.4 Miratimi i rregullore së personelit të burgjeve	2014	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children, QSHPLI, "Përthyerje", MERIDIA, FZKPM.	Rekomandime specifike prezantuar DPB
		1.1.5 Miratimi i Rregullore së brendshme të policisë së burgjeve	2014	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children, QSHPLI, "Përthyerje", MERIDIA, FZKPM.	Rekomandime specifike prezantuar DPB
		1.1.6 Miratimi i Rregullore së re të disiplinës dhe kodin e etikës për policinë e burgjeve	2014	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children, QSHPLI, "Përthyerje", MERIDIA, FZKPM.	Rekomandime specifike prezantuar DPB
		1.1.7 Miratimi i Rregulloreve të reja për IEVP	2015	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children, QSHPLI, Shoqata "Përthyerje", MERIDIA, FZKPM.	Ekspertize për hartim dhe konsultim Rekomandime specifike prezantuar DPB
		1.1.8 Miratimi i një rregulloreje të veçantë për trajtimin e të miturve të paraburgosur dhe të dënuar	2015	DPB	Save the Children, QSHPLI, KSHH, MERIDIA, FZKPM, QSHRT, IET, Shoqata "Përthyerje"	Pergatitja e draftit baze/tryeza dhe grupe pune për ndarjen me aktore të interesuar Rekomandime specifike për programet mbi të drejtat dhe liritë themelore dhe stanardet ndërkombetare, për të miturit
		1.1.9 Miratimi i Rregullave Standarde për kategorizimin dhe specifikimin e trajtimit për personat me nevoja të veçanta	2015	DPB	QSHRT	Hartimi i analizës krahasimore; përgatitja e udhëzuesit perkates dhe ndryshimet që duhen rekomanduar
2. Objektivi strategjik: Përmirësimi i shërbimeve të ofruar për kategorinë e personave me liri të kufizuar, mbështetur në trajtimin human dhe jo-diskriminues.						

DOKUMENT BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

2.1	Ulja e mbipopullimit në sistemin e burgjeve dhe paraburgimeve	2.1.1 Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me aktorë dhe grupet e interesit mbi çështjet e mbipopullimit	2015	DPB	KSHH QSHRT IET Shoqata “Përthyerje”	Ekspertize per uljet e mbipopullimit ne sistemin e burgjeve shqiptare permes tryezave te ekseperteve, studimeve dhe permiresimit te legjislacionit Bashke-organizimi i veprimtarive publike, ne kuader te respektimit te standardeve te trajtimit njerezor dhe problematikave qe mbart mbipopullimi. Rekomandime ne raportet dhe takimet me grupet e interesit e me gjere, ne tryezat e organizuara nga IET Ekspertize, pergatitje materialesh te natyres politike (policy papers).
		2.1.2 Hartimi i sistemi elektronik te analizes dhe standardeve per uljen e mbipopullimit, dhe problematikave te ndervarura (kushteve materiale, trajtimit njerezor, rehabilitimit, etj.)	2015-2016	DPB	QSHRT	Pergatitja e formatit, standardeve dhe kostove ne menaxhimin e ketij DATABASE
2.2	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor për personat me liri të kufizuar	2.2.1 Përmirësimi dhe ruajtja e një standardi të qëndrueshëm të kushteve higjieno-sanitare në IEVP	2014	DPB	KSHH QSHRT IET	Monitorim, raportim, trajnim te stafeve, dhe lobim prane dy ministrive per nje bashkepunim me efektiv Pergatitja e rekomandimeve specifike, bazuar ne standardet nderkombetare dhe legjislacionin ne fuqi Rekomandime ne raportet dhe takimet me grupet e interesit e me gjere, ne tryezat e organizuara nga IET
		2.2.2 Përmirësimi i sigurimit te medikamenteve	2014-2015	DPB	KSHH QSHRT	Monitorim, raportim, trajnim te stafeve, dhe lobim prane dy ministrive per nje bashkepunim me efektiv Pergatitja e rekomandimeve specifike, bazuar ne standardet nderkombetare dhe legjislacionin ne fuqi
		2.2.3 Hapja e Sektorëve të Kujdesit të Veçantë për personat me çrregullime të shëndetit mendor në sistemin e burgjeve	2014-2015	DPB	KSHH	Monitorim, raportim, trajnim te stafeve, ngritjen e sektoreve per te semuret mendore dhe lobim prane dy ministrive per nje bashkepunim me efektiv
		2.2.4 Përmirësimi i trajtimit të specializuar për riaftësimin shëndetësor	2015	DPB	KSHH QSHRT IET	Monitorim, raportim, trajnim te stafeve, dhe lobim prane dy ministrive per nje bashkepunim me efektiv Pergatitja e rekomandimeve specifike, bazuar ne standardet nderkombetare dhe legjislacionin ne fuqi Rekomandime ne raportet dhe takimet me grupet e interesit e me gjere, ne tryezat e organizuara nga IET
		2.2.5 Kalimi i shërbimit shëndetësor të sistemit të burgjeve në varësi të MSH	2017	DPB	KSHH, QSHRT, IET	Pergatitja e rekomandimeve specifike, bazuar ne standardet nderkombetare dhe legjislacionin ne fuqi
2.3	Përmirësimi i procesit të rehabilitimit social dhe ri-integrimit në shoqëri të personave me liri të kufizuar	2.3.1 Orientimi i sistemit të burgjeve drejt praktikave më të mira evropiane për ofrimin e shërbimeve cilësore të arsimit, formimit profesional dhe punësimit.	2014-2017	DPB	KSHH IET	Trajnimet e stafeve per rritjen e tyre profesionale, me tryeza ekspertesh per sa i takon permiresimeve te dosjeve psikosociale dhe sistemit te raportimit ne perqithesi dhe per kategori te vecanta si te semuret mendore dhe te miturit. Rekomandime ne raportet dhe takimet me grupet e interesit e me gjere, ne tryezat e organizuara.

DOKUMENT BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

					Shoqata “Përthyerje”	Ekspertize, vizita studimore per stafin e burgjeve Trajnime
		2.3.2 Hartimi i programeve të ri-integrimit, me fokus kategoritë në nevojë si të miturit, gratë, 18-21 vjeçar dhe personat pa mbështetje	2014	DPB	Save the Children MERIDIA,IET	Mbeshetje financiare/ekspertize Rekomandime ne raportet dhe takimet me grupet e interesit e me gjere
		2.3.3 Hartimi i protokolleve standarde mbi përgatitjen për ri-integrim për kategoritë specifike	2014	DPB	Save the Children, MERIDIA IET	Mbeshetje me eksperte/tavolina/gupe pune për kategorinë e të miturve Rekomandime ne raportet dhe takimet me grupet e interesit e me gjere
		2.3.4 Bashkëpunimin me Institucione shtetërore , OJF dhe komunitetin e biznesit për ndërtimin e rrjeteve mbështetëse pas lirit	2015	DPB	KSHH, Save the Children, QSHRT, IET, “Përthyerje”,MERIDIA, FZKPM, QSHPLI	Hartimi i projekteve te perbashketa dhe fuqizimi i partneriteteve rajonale. Shërbime rehabilituese dhe riintegruese Aktivitete koordinuese dhe sensibilizuese
		2.3.5 Aplikimi për projekte të përbashkëta me shoqërinë civile me fokus rehabilitimin dhe përgatitjen për ri-integrim	2014-2015	DPB	KSHH, Save the Children, QSHRT, IET, “Përthyerje”, MERIDIA, FZKPM, QSHPLI	Hartimi i projekteve te perbashketa dhe fuqizimi i partneriteteve rajonale. Shërbime rehabilituese dhe riintegruese.
		2.3.6 Bashkëpunimi me Strukturat e Sherbimit te Proves dhe pushtetin vendor per te adresuar nevojat e grupeve me nevoja te veçanta dhe perfitimin e alternativave perkundrejt burgimit.	2015	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children,	Rekomandime specifike, bazuar ne standardet nderkombetare dhe legjislacionin ne fuqi
2.4	Krijimi i një sistemi efektiv për punësimin dhe shpërblimin për punën e të dënuarve/të paraburgosurve	2.4.1 Nxitja e iniciativave private për punësimin e të burgosurve brenda dhe jashtë sistemit	2015-2017	DPB	QSHRT Save the Children	Marreveshjet tip, bashkepunim dhe korrespondence, referim rastesh Ofrimi i modeleve pilot per punesimin e te rinjve 16 - 18 vjec ne biznese te vogla dhe te mesme jashte sistemit
		2.4.2 Krijimi i mundësive për zbatimin e projekteve ne bashkëpunim me komunitetin e biznesit për ofrimin e laboratoreve apo punishteve te prodhimit brenda sistemit penitenciar	2015-2017	DPB	QSHRT, MERIDIA Shoqata “Përthyerje”	Marreveshjet tip, bashkepunim dhe korrespondence, referim rastesh Ngritje laboratorit per punimet e dorës (me shtiza) në IEVP Ali Demi
		2.4.3 Nxitja e punës kërkimore për gjetjen e zgjidhjeve dhe zbatimin e metodave bashkëkohore për punësimin e të burgosurve	2015-2017	DPB	KSHH, QSHRT, Save the Children, MERIDIA	Bashkëpunim nëpërmjet programeve te standardizuara
2.5	Rritja e performancës profesionale dhe operacionale të punonjësve të sistemit penitenciar	2.5.1 Hartimi i protokolleve për qartësimin e kompetencave dhe detyrave funksionale	2014	DPB	QSHRT	Kontribut specifik per permiresimin e punes se stafit profesional mjekesor
		2.5.2 Konsolidimi i kurrikulës së trajnimeve dhe vlerësimit	2014	DPB	KSHH QSHRT	Organizim trajnimesh per rritjen profesionale te stafeve multidisiplinore ne sistemin e burgjeve dhe rritjen e performances se tyre permes monitorimeve dhe raportimit te performances se tyre ne zbatimin e legjislacionit ne fuqi. Marreveshje, bashkepunim dhe komentare mbi kurrikulat.

DOKUMENT BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

					Shoqata “Përthyerje”	Hartim Modulesh, trajnime
		2.5.3 Forcimi i kapaciteteve të sektorit të trajnimeve nëpërmjet organizimit të sesioneve “Trajnim trajnerësh”.	2014	DPB	QSHRT, KSHH, Shoqata “Përthyerje”	Marreveshje, bashkëpunim dhe komentare mbi kurrikulat
		2.5.4 Organizimi i trajnimeve për punonjës të niveleve të ndryshme për ngritje në karrierë, si dhe aftësitë menaxheriale të drejtimit	2015	DPB	KSHH, QSHRT, Shoqata “Përthyerje”	Trajnime, ekspertizë dhe komente mbi kurrikulat.
		2.5.5 Konsolidimi i një sistemi trajnimesh specifike për stafet që punojnë me të miturit, gratë dhe personat me çrregullime të shëndetit mendor, si dhe në çështjet e mos-diskriminimit dhe parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit	2014-2017	DPB	KSHH, Save the Children, FZKPM, MERIDIA, FZK QSHRT Shoqata “Përthyerje” Psikologu shqiptar	Bashkëpunim për hartimin e moduleve për trajtimin e te miturve Trajnime dhe ekspertizë për kurrikulat.
3. Përmirësimi i infrastrukturës fizike, materiale dhe teknologjisë në sistemin penitenciar.						
3.1	Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe materiale të institucioneve aktuale	3.2.1 Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe materiale në institucionet/sectorët për të miturit	2014	DPB	Save the Children IET	Mbeshtetje financiare/ materiale Rekomandime në raportet dhe takimet me grupet e interesit e me gjere, në tryezat e organizuara nga IET(në vazhdim)
		3.2.2 Përmirësimi i kushteve materiale për të paraburgosurit dhe të dënuarit.	2015-2016	DPB	IET	Rekomandime në raportet dhe takimet me grupet e interesit e me gjere, në tryezat e organizuara nga IET(në vazhdim)
4. Objektivi strategjik: Rritja e partneritetit për respektimin e të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve.						
4.1	Rritja e bashkëpunimit me institucione shtetërore	4.1.1 Rinovimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me MMSR për procesin e formimit profesional në IEVP	2014	DPB	KSHH	Lobim për një bashkëpunim më të mirë me sistemin të burgjeve dhe institucioneve të tjera të sistemit të drejtësisë dhe jo vetëm. Përfshirja e gjithë aktoreve relevante që kontribuojnë në riintegrimin e personave të privuar nga liria në rikthimin e tyre të sukseshëm në shoqëri.
		4.1.2 Bashkëpunimi me institucione dhe agjenci shtetërore në nivel lokal	2014-2015	DPB	KSHH Shoqata “Përthyerje”	Pjesëmarrje në rrjetin e bashkëpunimit, ekspertizë
4.2	Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile	4.2.1 Bashkëpunimi për identifikimin e prioriteteve në funksion të zbatimit të projekteve të përbashkëta	2014-2017	DPB	KSHH, QSHRT, IET, Save the Children, QSHPLI, “Përthyerje”, MERIDIA, FZKPM dhe OJF të tjera	Pjesëmarrje në takime të përbashkëta, Termat e referencës, ekspertiza dhe kualiteti profesional
		4.2.2 Kryerja e studimeve kërkimore-shkencore me interes të përbashkët	2014-2017	DPB	QSHRT, IET Shoqata “Përthyerje”	Termat e referencës, ekspertiza dhe kualiteti profesional. Identifikim nevojash dhe hartim projektesh
5. Objektivi strategjik: Eleminimi i akteve korruptive dhe fenomeneve të tjera negative në sistemin e burgjeve.						
5.1	Përmirësimi i procedurave anti-korruption	5.1.1 Ngritja e një grupi pune për hartimin e udhëzuesve administrativë kundër korruptionit	2014	DPB	KSHH	Monitorimi i strukturave të brendshme të cilat luftojnë korruptionin në sistemin e burgjeve; si edhe në studime të reja pas hershme të këtyre strukturave, kompetencat e tyre dhe procedurat.

DOKUMENT BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

					QSHRT	Termt e references, ekspertiza dhe kualiteti profesional
		5.1.2 Krijimi i një database për standardizimin dhe administrimin e të dhënave mbi rastet korruptive në sistemin e burgjeve	2014	DPB	QSHRT	Termt e references, ekspertiza dhe kualiteti profesional
		5.1.3 Forcimi i adresimit për ndjekje ligjore të rasteve të korrupsionit në administratën e burgjeve	2014-2017	DPB	QSHRT	Termt e references, ekspertiza dhe kualiteti profesional
		5.1.4 Organizimi i fushatave sensibilizuese me personat me liri të kufizuar për denoncimin e rasteve korruptive dhe abuzive në IEVP	2014-2017	DPB	QSHRT	Termt e references, ekspertiza dhe kualiteti profesional
		5.1.5 Konsolidimi i bashkëpunimit për identifikimin e akteve korruptive	2014-2017	DPB	QSHRT, IET, Shoqata "Përthyerje"	Termt e references, ekspertiza dhe kualiteti profesional Vizita monitoruese në të gjitha IEVP me stafe multidisiplinare, botime të Raporteve Monitoruese (Përmbledhje)